

Përmbajtja:

1: Hyrje

- 2: Veprimtari kryesore
- 3: Formimi Fillestar
- 4: Formimi Vazhdues
- 5: Sektori i TI
- 6: Agjenda e muajit prill

1. Hyrje

Të nderuar,

Ju prezantojmë me numrin e trete të **Buletinit Informativ të Shkollës së Magjistraturës**, mbi veprimtarinë e saj akademike dhe administrative gjatë muajit Mars.

2. Veprimtari kryesore

Ndryshimet e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, datë 28.1.2026, u reflektuan në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, miratuar në mbledhjen e Këshillit Drejtues datë 6.3.2026.

Në zbatim të tyre nga data 9 -30 mars 2026 u zhvillua procesi i regjistrimit të gjithë të interesuarëve për të konkurruar për profilin ndihmës ligjor (36 vende vakante) në Shkollën e Magjistraturës.

Konkurrentët dorëzuan kopjen e dokumenteve fizikisht pranë Komisionit të Pranimit të Dokumentacionit nga e hëna në të premte, nga ora 9:00 deri në orën 14:00.

Formimi Fillestar Zemra e magjistratëve të rinj

Aktivitetet e muajit

- Regjistrimi i konkurrentëve për ndihmës ligjor
- Zhvillimi i procesit mësimor nga e hëna në të premte, nga ora 8:30 deri në orën 16:50.

- Zhvillimi i vlerësimit të dytë në lëndën e gjyqimit kushtetues, gjyqimit civil dhe gjyqimit familjar, i mituri dhe viktimi.
- Klinika ligjore
- Zhvillimi i praktikës paraprofesionale nga kandidatët për magjistratë të vitit të dytë.
- Zhvillimi i gjyqeve imituese nga kandidatët e vitit të dytë.
- Zhvillimi i praktikës profesionale nga kandidatët e vitit të tretë në gjykata dhe prokurori.
- Bashkëbisedimi me ministrat e integritetit rreth procesit të integritetit në BE.

Viti i parë

Gjatë muajit mars krahas mësimin në auditor u zhvilluan edhe tri vlerësime të programuara në lëndën e gjyqimit kushtetues, gjyqimit civil dhe gjyqimit familjar.



Çaste nga vlerësimi në gjykimin kushtetues dhe gjykimin civil mars 2026



“Magjistratët e së ardhmes përdorin sot mjetet e së ardhmes: SMVSHM dhe TEAMS e bëjnë procesin e formimit më të lehtë dhe më afër standardeve evropiane.”

Viti i dytë

Kandidatët për magjistratë të vitit të dytë mbaruan kursin e psikologjisë. Kandidatët iu nënshtruan edhe vlerësimit përfundimtar sipas planit mësimor.

Kursi praktik i klinikës ligjore shënoi ndarjen e grupeve dhe mentorëve përkatës. Kandidatët u ndanë në 15 grupe dhe do të interpretojnë pyetjet e ardhura nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme dhe nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nën drejtimin e pedagogëve të klinikës ligjore.

Nga data 2 mars deri në datën 24 prill 2026 kandidatët



për gjyqtar do të zhvillojnë praktikën paraprofesionale në Gjykatën Administrative, ndërsa kandidatët për prokuror në Gjykatën e Shkallës së Parë, dhoma penale.

Zhvillimi i gjyqeve imituese

Gjatë muajit mars janë realizuar takimet paraprake mes grupeve të gjyqeve imituese dhe pedagogëve përkatës, duke përcaktuar fabulat e gjyqeve dhe piketat se ku do të përqendrohen anëtarët e secilit grup. Gjyqet imituese do të zhvillohen në fund të muajit mars dhe në fillim të muajit prill.

Në datën 2 mars, kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar dorëzuan dosjen e parë penale, ndërsa kandidatët për prokurorë dorëzuan dy dosje penale, pas praktikës në gjykatën e shkallës së parë dhe prokurorinë e përgjithshme.

“Praktika është laborator ku formohet magjistrati i së ardhmes, me mendje të mprehtë dhe zemër të përkushtuar ndaj drejtësisë.”

Viti i tretë

Kandidatët e vitit të tretë vijojnë praktikën profesionale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në dhomat civile dhe penale, si dhe në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

“Drejtësia dhe të drejtat e njeriut nuk mund të jenë selektive.”

Vittorio Arrigoni

Orari për muajin prill

MUAJI PRILL												
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 25	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2		
8:30					GJP	GJS	GJF	GJA	Vlerësim 3	GJK		
12:00					GJP	GJC		GJA				
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 26	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2		
8:30 - 11:20			GJC 5	GJP	GJP	GJS	GJF	GJK	GJK	GJF		
12:00 - 14:50			GJC	GJP	GJP	GJC						
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 27	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2		
8:30 - 11:20			GJP	GJP	GJC	GJC	GJF	GJK	GJK	GJF		
12:00 - 14:50			GJP	GJP	FUND	FUND						
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 28	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2		
8:30 - 11:20	GJA	GJF	MO/D8	GJP	GJP	MO/D8	GJK	GJA	GJF	GJK		
12:00 - 14:50	GJA			GJP	GJP			GJA				
Orari	E hënë		E martë		E mërkurë		E enjte		E premte		E shtunë	E diel
Java 29	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2	Klasa 1	Klasa 2		
8:30 - 11:20	GJA	Admini	GJF	Myds6	Vlerësim final	GJP	Mjds	GJF				
12:00 - 14:50	Vlerësim final				FUND							
	FUND	FUND										

Aktivite institucionale

Ditën e premte, më 27.3.2026, në orën 9:30, në sallën e amfiteatrit të Godinës “Poli i Drejtësisë”, u zhvillua bashkëbisedimi mbi procesin e integritimit në Bashkimin Evropian: “BE-ja dhe ti. Evropa në shtëpi”. Ky aktivitet u organizua në kuadër të bashkëpunimit institucional të Shkollës së Magjistraturës me: Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministrinë e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, të përfaqësuara nga z. Ferit Hoxha dhe znj. Adea Pirdeni, me pjesëmarrjen e Drejtorit të Shkollës, z. Arben Rakipi, pedagogëve të brendshëm, si dhe kandidatëve për magjistratë të SHM-së.

Ky takim kishte një rëndësi të veçantë, pasi u zhvillua në një moment kyç të rrugëtimit të Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Diskutimet u përqendruan në dinamikat aktuale të procesit të negociatave, sfidat institucionale, mundësitë, rolin e sistemit të drejtësisë dhe standardet që çdo magjistrat duhet të përmbushë me sukses drejt integritimit evropian. Takimi ndërtoi një kuadër më të gjerë informues dhe profesional për rolin që çdo institucion—përfshirë Shkollën e Magjistraturës—luan në përmbushjen e këtij procesi strategjik për vendin.

Hartimi i tezave



Bazuar në vendimin nr. 38, datë 17.12.2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës” të Këshillit Drejtues, ku u vendos mbi ristrukturimin e rubrikave për fazën e parë

(scantron), për programin e provimit të pranimit për kandidatët për magjistratë, për këshilltarë, ndihmës ligjorë dhe avokat shteti për vitin akademik 2026-2027, komisionet përkatëse kanë vijuar intensivisht punën për hartimin e pyetjeve të reja bazuar në ristrukturimin e rubrikave.



Komisioni i Verifikimit të Dokumentacionit

Pas përfundimit të procesit të dorëzimit të dokumentacionit nga konkurrentët për provimin e pranimit në Shkollën e Magjistraturës, filloi nga puna Komisioni i Verifikimit të Dokumentacionit. Ky komision pasi verifikoi në mënyrë të hollësishme nëse konkurrentët plotësonin kriteret e parashikuara në ligjin nr. 96/2016, përpiloi listën me emrat e të kualifikuarve dhe të atyre që nuk i përmbushnin kriteret. Gjithsej u regjistruan 318 konkurrentë. Çdo informacion në lidhje me statusin e tyre, konkurrentët e gjejnë në llogarinë e tyre në platformën SMVSHM.



Formimi Vazhdues

Gjatë muajit mars 2026, Shkolla e Magjistraturës zhvilloi 22 aktivitete trajnuese në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe subjekteve të tjera ligjore nga të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë. Aktivitetet u fokusuan në forcimin e kapaciteteve profesionale, unifikimin e praktikës gjyqësore dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare.

Këto trajnime u ndoqën në total nga 367 pjesëmarrës (numër total pjesëmarrjesh).

Aktivitetet trajnuese të muajit mars 2026 u zhvilluan në kuadër të moduleve:

- **Sigurimi i Provës** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Viktima dhe i mituri në procesin penal** – [grup i synuar, gjyqtarë, prokurorë, opgj]
- **Media** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Korrupsioni** – [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Çështje të së drejtës familjare dhe të miturve** – [grupi i synuar, gjyqtarë, prokurorë]
- **Pastrimi i parave** - [grupi i synuar, gjyqtarë penalistë, prokurorë, hetues, opgj]
- **Trajnime të posaçme 1 ditore si** “Ekuilibrimi i së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare me lirinë e shprehjes”.

Në datat 17 dhe 18 mars 2026, në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues, u zhvilluan dy trajnime të specializuara në bashkëpunim me Qendrën CEDI të Ambasadës Britanike në Tiranë, me temë: “*Teknikat forenzike të trajtimit të provave*”.

Ky bashkëpunim i Shkollës së Magjistraturës me Ambasadën Britanike u mbështet si në aspektin logjistik, ashtu edhe në atë të ekspertizës, duke angazhuar në panelin e trajnimit katër ekspertë të huaj me përvojë të gjerë në fushën e teknikave forenzike.

Trajnimi i datës 17 mars, me temë “*Teknikat Forensic të trajtimit të provave. Udhëzuesi i prokurorit për përdorimin e provave mjekësore në rastet e dhunës seksuale ; Zinxhiri i ruajtjes së provës*”, kishte grup të synuar prokurorët e rinj.



Foto. Trajnim datë 17 mars “*Teknikat Forensic*”

Trajnimi i datës 18 mars, me temë “*Teknikat Forensic të trajtimit të provave. Provat forenzike në ndjekjet penale për terrorizëm; Roli i gjyqtarit në gjykim në lidhje me gjykatat shqiptare. Roli i gjyqtarëve në shqyrtimin kritik të provave forenzike dhe në ruajtjen e integritetit të këtyre provave*”, kishte grup të synuar gjyqtarët e rinj.



Foto. Trajnim datë 18 mars “Teknikat Forensic”

Foto. Trajnim Trajnerësh, ToT, datë 27 mars 2026.

Në datë 27 mars 2026, Shkolla e Magjistraturës në Bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit, “*Forcimi i efikasitetit, integritetit dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë përmes rritjes së kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës*”, zhvilloi trajnimin e dytë të trajnerëve me temë, “*E drejta e BE-së: Çështje kryesore*”.

Ky aktivitet kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve të trajnerëve në zbatimin e metodologjive interaktive të trajnimit në një temë që lidh të drejtën shqiptare me atë të Bashkimit Evropian. Ky trajnim vjen si pjesë e grupit të aktiviteteve trajnuese që po realizon Shkolla e Magjistraturës në bashkëpunim me Shkollën holandeze të trajnimit gjyqësor (SSR) për të rritur aftësitë e trupës pedagogjike në zbatimin e kurrikulave të reja.

Përmes tematikës së përzgjedhur synohet gjithashtu forcimi i kapaciteteve në fushën e së drejtës evropiane.

Metodologjia e aktiviteteve trajnuese

Trajnimet u realizuan duke ndërthurur prezantimet (deri në 20-30 min) me diskutimin e çështjeve të shtruara (pyetjeve vetë studimore; pyetje-përgjigje) dhe ushtrimeve me raste praktike & kuize, për të nxitur dhe realizuar ndërveprimin aktiv të pjesëmarrësve.

Për muajin **prill** janë planifikuar:

- **21 trajnime të formimit vazhdues**

Teknologjia e informacionit

Gjatë muajit Mars 2026 u zhvillua një takim informues me kandidatët e vitit të tretë, gjatë të cilit u prezantuan përfitimet dhe funksionalitetet e Sistemit të Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës (SMVSHM).



Në vijim, u realizua një fazë pilotimi për testimin e funksionalitetit të ri të sistemit, i cili mundëson gjenerimin automatik të listës së pjesëmarrësve në një trajnim të caktuar, bazuar në numrin e aplikimeve, numrin maksimal të pjesëmarrësve, fushën e ekspertizës, si dhe algoritme të tjera përzgjedhjeje.

Faza e pilotimit rezultoi e suksesshme, duke përfshirë rreth 500 aplikime në tema të ndryshme trajnimi të parashikuara në kalendarin aktual, për periudhën nga 1 maji 2026 deri në përfundim të tij. Aplikimet e kandidatëve janë duke ndihmuar në adaptimin sa më të saktë të algoritmit i cili pritet të vendoset në punë për vitin akademik 2026-2027.

• Mbledhje e Këshillit Drejtues - 6 mars 2026

Në mbledhjen e datës 6 mars 2026, të zhvilluar në ambientet e Gjykatës së Lartë, Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës shqyrtoi dhe miratoi disa çështje kryesore: shpalljen e vendeve vakante për ndihmës ligjorë, bazuar në propozimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe caktimin e datës së provimit të pranimit; programin e provimit për këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë të gjykatave dhe prokurorive, përfshirë Prokurorinë e Posaçme; disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren e Brendshme të institucionit; komandimin për një afat të ri 3-vjeçar të një pedagogu nga rradhët e magjistratëve sipas vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor; si dhe publikimin e listës së kandidatëve për magjistratë që kanë kaluar procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës.

Ju ftojmë të vizitoni rregullisht faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës për informacion të përditësuar mbi programet dhe veprimtaritë tona.

Me respekt,

Shkolla e Magjistraturës

www.magjistratura.edu.al

E-mail: info@magjistratura.edu.al



AGJENDA E MUAJI PRILL

Kalendari i trajnimeve

<u>Prill 2026</u>				
1.	MODUL b.3 “EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM” Titujt ekzekutivë, llojet e akteve të parashikuara nga ligji, praktika gjyqësore. <i>(Grupi i synuar përmbaruesit gjyqësorë)</i>		Ekspertë: Dashamir Kore Altin Shkurti Lehtësues: Alda Sadiku	<u>1 prill</u> 2026
2.	Mjetet e mbrojtjes në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore. Parashkrimi i dënimit administrativ me gjobë. Problemet e hasura në praktikën gjyqësore. Padi të në fazën e ekzekutimit të titullit ekzekutiv. Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv <i>(Grupi i synuar përmbaruesit gjyqësorë)</i>		Ekspertë: Vangjel Kosta Julian Haxhiu Lehtësues: Hazbi Balliu	<u>2 prill</u> 2026
3.	Dëmi pasuror dhe jo pasuror nga aksidentet në punë në dritën e jurisprudencës gjyqësore.		Ekspertë: Enton Dhimitri Dritan Caka Lehtësues: Ardiola Çela	<u>3 prill</u>
4.	MODUL e.2 “MEDIA” Format e ndikimit të medias te sistemi i drejtësisë. Komunikimi në kohë “krize”. Situatat që kapin në befasi sistemin e drejtësisë, menaxhimi i tyre për të mos lejuar dëmtimin e imazhit të strukturave të drejtësisë në sytë e publikut.	Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës	Ekspertë: Gerd Hoxha Zylyftar Bregu (specialist fushe)	<u>7 prill</u> 2026



			Ekspert nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës Lehtësues: Olkeda Lice	
5.	MODUL b.3 “EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM” Konventa e Hagës për marrëveshjen për zgjedhjen e Gjykatës (2005) dhe Konventa e Hagës për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile ose tregtare të gjykatave të huaja (2019). Implikimet ligjore dhe praktike.		Ekspertë: Aida Bushati Flutura Kola Lehtësues: Olti Skrame	7 prill 2025
6.	MODUL a.12 “ PROVAT DHE MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS NË PROCESIN PENAL Dëshmia dhe kufijtë e saj. Dëshmia indirekte, zotësia për të dëshmuar, papajtueshmëria me detyrën e dëshmitarit, dëshmitari me identitet të fshehur, kundërshtimi i dëshmisë, përgjegjësia për dëshmi të rreme dhe detyrimi i gjykatës për referimin e veprës penale. Rregullat e pyetjes së dëshmitarëve në distancë, detyrimi i respektimit të procedurës ligjore.		Ekspertë: Sokol Binaj Arqilea Koça Lehtësues: Besmir Stroka	8 prill 2026
7.	MODUL d.1 “ DISKRIMINIMI ” Ndalimi i diskriminimit në ligjin ndërkombëtar, evropian dhe shqiptar. Standardet dhe barra e provës. Marzhet e vlerësimit. Arsyetimi i vendimit nga gjykata. E drejta e ankimit.	Në bashkëpunim me Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare (QNL)	Ekspertë: Robert Gajda Fiona Papajorgji Aurela Anastas Lehtësues: Ina Hoxhaj	9 prill 2026
8.	Liria e shprehjes dhe mbrojtja e gazetarëve.		Ekspertë Margarita Buhali Edlira Petri	15 prill 2026



			Lehtësues Zylyftar Bregu Moderator Aida Bushati	
9.	Liria e shprehjes dhe mbrojtja e gazetarëve.		Ekspertë Margarita Buhali Edlira Petri Lehtësues Zylyftar Bregu Moderator Aida Bushati	<u>16 prill</u> <u>2026</u>
10.	MODUL a.12 “PROVAT DHE MJETET E KËRKIMIT TË PROVËS NË PROCESIN PENAL ” Njohja e personave, sendeve si dhe objekteve që mund të jenë objekt i perceptimit shqisor. Subjektet që mund të bëjnë njohjen, përfshirë bashkëpandehurin dhe të pandehurin në një procedim të lidhur. Rregullat procedurale të pyetjes së personit që duhet të bëjë njohjen. Pasojat e moszbatimit të këtyre rregullave në rezultatet e njohjes. Procedura e njohjes dhe ndryshimet ligjore sipas ligjit Nr.35/2017. Sigurimi i personave/objekteve të ngjashme, rëndësia e këtij rregulli në rezultatin e njohjes. Prania e detyrueshme e mbrojtësit gjatë njohjes. Identifikimi i të pandehurit me anë të fotografisë, dallimi midis njohjes dhe identifikimit/individualizimit të të pandehurit. Pavlefshmëria e njohjes, mundësia e përsëritjes së njohjes nga i njëjti person dhe problematikat në praktikën gjyqësore.		Ekspertë: Tereza Merkaj Kreshnik Ajazi Lehtësues: Gjergji Ceka	<u>17 prill</u> <u>2026</u>
11.	Ekspertimi, kushtet e vlefshmërisë dhe përdorshmërisë. Caktimi i detyrave të ekspertit, shmangia e detyrave që konsistojnë në dhënien e mendimeve juridike, ri-ekspertimi, vlerësimi i ekspertimit në rastet e dhënies së mendimeve të veçanta nga ekspertët. Praktika gjyqësore lidhur me ekspertimin si provë në procesin penal dhe rastet e pavlefshmërisë. Caktimi i ekspertëve dhe marrja e akteve të		Ekspertë: Igerta Hysi Gerd Hoxha	<u>20 prill</u> <u>2026</u>



	ekspertizës nga organet shtetërore që kanë në kompetencë dhënien e mendimit të specializuar. Caktimi i ekspertëve nga Instituti i Mjekësisë Ligjore.		Lehtësues: Florin Demollari	
12.	MODUL a.9 “KORRUPSIONI” Parashikimet ligjore lidhur me veprën penale të korrupsionit. Historiku i rregullimit ligjor dhe ndryshimet ligjore ndër vite. Parashikimet ndërkombëtare mbi korrupsionin dhe zbatimi i Konventave të detyrueshme. Veprat penale të korrupsionit në Kodin Penal.		Ekspertë: Sandër Simoni Tereza Merkaç Lehtësues: Gazmend Frëngu	<u>20 prill</u> <u>2026</u>
13.	MODUL a.13 “ GJYKIMI NË SEANCËN PARAPRAKE ” Kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, roli i tij në procesin penal. Kufiri lidhur me vlerësimin dhe çmuarjen e provave. Mundësitë e vendimmarrjeve të gjyqtarit të seancës paraprake. Problematikat në praktikë lidhur me disponimin për plotësimin e hetimeve, përllogaritjen e afateve të paraburgimit në rastin e disponimit për plotësimin e hetimeve, pushimin e çështjes, ndryshimin e akuzës. Ndarja e çështjes në gjykimin në seancë paraprake dhe parashikimi ligjor lidhur me detyrimin e shqyrtimit të çështjeve të ndara nga i njëjti gjyqtar i seancës paraprake. Zbatimi i rasteve të papajtueshmërisë.		Ekspertë: Sokol Binaj Adelajda Gjuzi Lehtësues: Artur Prenga	<u>21 prill</u> <u>2026</u>
14.	Natyra e vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake. Efektet e vendimmarrjes së gjyqtarit të seancës paraprake lidhur me shqyrtimin e kërkesave për pavlefshmërinë e akteve apo papërdorshmërinë e provave dhe përsëritja e kërkesave në gjykimin në themel. Ankimi ndaj vendimeve të gjyqtarit të seancës paraprake.		Ekspertë: Amarildo Laçi Henrik Ligori Lehtësues: Odetë Todorushi	<u>22 prill</u> <u>2026</u>
15.	MODUL a.14 “MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME JASHTË” Njohja e vendimeve penale të huaja. Roli i gjykatës në njohjen e vendimeve penale, caktimin/konvertimin e dënimeve dhe		Ekspertë: Ilir Panda Erjon Bani	<u>23 prill</u> <u>2026</u>



	dënimin që duhet të ekzekutohet në shtetin shqiptar. Problematikat e hasura në praktikë dhe praktika gjyqësore.		Lehtësues: Gentian Jahjollli	
16.	Ekstradimi. Kushtet e ekstradimit, kërkesa e prokurorit dhe procedura për kryerjen e ekstradimit. Pasojat e mosrespektimit të afateve ligjore lidhur me kryerjen e procedurave të ekstradimit. Rastet e mospranimin të ekstradimit. Ndryshimet ligjore lidhur me marrjen formë të prerë të vendimit të ekstradimit. Ekstradimi i thjeshtuar dhe zbatimi i tij në praktikë.		Ekspertë: Klodian Kurushi Amarildo Laçi Lehtësues: Aulon Pashaj	24 prill 2026
17.	Trajnim 1 ditor Likuidimi i shoqërive tregtare në gjendje të aftësisë paguese. Paaftësia paguese si shkak për likuidimin sipas rregullave të Ligjit “Për falimentimin”.		Artan Hajdari Vangjel Kosta Lehtësues: Antonela Prendi	27 prill 2026
18.	MODUL a.13 “ GJYKIMI NË SEANCËN PARAPRAKE” Pavlefshmëria e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Mosrespektimi i dispozitave lidhur me njoftimin e të pandehurit dhe pezullimin e gjykimit në seancë paraprake, efektet mbi gjykimin e themelit. Kompetencat e gjyqtarit të themelit për konstatimin e pavlefshmërisë, detyrimi i vazhdimin të gjykimit të themelit pavarësisht elementëve të pavlefshmërisë së vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Praktika gjyqësore dhe qëndrimet e Gjykatës së Lartë në rast të referimeve për konfliktin e kompetencave midis gjyqtarit të themelit dhe gjyqtarit të seancës paraprake.		Ekspertë: Ilir Panda Nurjeta Pogaçe Lehtësues: Thomaidha Roça	28 prill 2026
19.	MODUL a.9 “KORRUPSIONI” <u>Hetimi Proaktiv në luftën kundër korrupsionit: prokurimeve publike, veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet, si dhe hetimi pasuror në çështjet që lidhen me to.</u>	Prokuroria e Përgjithshme	Ekspertë: Esmeralda Keshi (Cami) Antoneta Sevdari	29 prill 2026



			Lehtësues: Matilda Peza	
20.	MODUL b.5 “KONTROLI I AKTEVE TË ORGANEVE TË SHOQËRISË TREGTARE. NATYRA E VENDIMARRJES SË GJYKATËS” Gjykimi i mosmarrëveshjeve për shfuqizimin e vendimeve të organeve të administrimit të shoqërive tregtare. Natyra juridike e kontrollit të brendshëm të vendimeve të organeve të shoqërisë. Pavlefshmëria relative dhe pavlefshmëria absolute e akteve të nxjerra nga organet e shoqërive të kapitalit. Natyra juridike e pasojave të pavlefshmërisë së akteve të nxjerra nga organet të shoqërisë.		Ekspertë: Artan Hajdari Alma Hicka Lehtësues: Erlanda Agaj	29 prill <u>2026</u>
21.	Paditë që lidhen me kontrollin e akteve të shoqërisë me natyrë konfliktet që lindin nga largimi dhe përjashtimi i ortakut. Natyra e vendimmarrjes në “procedurën e brendshme” në largimin dhe përjashtimin e ortakut. Kundërshtimi në gjykatë i vendimmarrjes së AP në rastin e largimit dhe përjashtimit të ortakut dhe natyra e vendimmarrjes së gjykatës. Natyra e padive që lidhen me dëmshpërblimin/kompensimin financiar si në rastin e largimit ashtu dhe atë të përjashtimit nga shoqëria.		Ekspertë: Fatri Islamaj Artan Hajdari Lehtësues: Diamela Goxha	30 prill <u>2026</u>